

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
Rr. 'Skerdilajd Llagami' | Nd.3, H.1, Ap.9
Tirane
(T/F): +35542468492 | (M): +355682050310
(E): aam@albmail.com | (W): aam.org.al



Projekti “Dieta Mesdhetare” Interreg MED

Thirrje për shprehje interesi

12 tetor 2020

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë hap thirrjen për përzgjedhjen e individëve apo sipërmarrjeve që do të përfitojnë mbështetje për pesë (5) produkte agro-ushqimore / ose shërbime të lidhura me to.

Të dhëna mbi projektin

Listuar si pjesë e Trashëgimisë Jomateriale të Njerëzimit, Dieta Mesdhetare është pjesë përbërëse e identitetit mesdhetar. Ajo përfshin një set aftësish, njohurish, ritualeve, simboleve dhe zakoneve lidhur me kulturën, mjedisin, metoda të punës dhe stilin e jetesës që karakterizojnë një industri të fuqishme. Megjithatë, disa zona rurale të Mesdheut i nënvlerësojnë këto mekanizma dhe hasin mangësi demografike dhe natyrore të shkaktuara nga mungesa e njohurive mbi potencialin ekonomik të kësaj pjese të identitetit kulturor mesdhetar.

Projekti MD.net adreson probleme të neglizhimit dhe mos shfrytëzimit të mundësive të Dietës Mesdhetare. Qëllimi kryesor i projektit është rritja e njohurive mbi Dietën Mesdhetare sipas Konventës së UNESCO për Dietën Mesdhetare, duke ndërthurur koncepte të kësaj diete me mjete inovatore. Projekti do të përdorë masa tradicionale dhe kreative (si ekonomia e përbashkët) duke nisur bashkëpunimin me qëllim ngritjen e ekonomisë së Dietës Mesdhetare në nivele të reja cilësie.

Qëllimi i Thirrjes

Përfaqja e Projektit përbëhet nga disa blloqe aktivitetesh të pazhvilluara më parë në sektorët e Dietës Mesdhetare. Kjo thirrje lidhet me aktivitetin MD.InC – Inovacion dhe kreativitet i produkteve dhe shërbimeve përmes një platforme të qëndrueshme.

Shoqata e Bashkive fton individë dhe sipërmarrje nga zona pilot e projektit që shtrihet në bashkitë Lezhë dhe Shkodër të paraqesin kërkesën e tyre për mbështetje dhe këshillim falas për shërbime lidhur me marketingun, promovimin, hulumtim të tregut, analiza të situata aktuale ose propozime të tjera për të përmirësuar veprimtarinë tregtare.

1. Prezantimi i mbështetjes

Si pjesë e projektit MD.Net, do të përzgjidhen 5 produkte/shërbime nga biznese të vogla lokale të cilat do të mbështeten sipas nevojave të tyre lidhur me marketingun, shpërndarjen promovimin etj. Përzgjedhja e produkteve/shërbimeve do të kryhen gjatë disa takimeve të organizuara nga Shoqata e Bashkive ku do të diskutohen dhe përpunohen aplikimet e marra. Individët apo sipërmarrjet pjesëmarrëse nuk do të përfitojnë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare, por shërbime të ofruara nga projekti.

Përfaqësuesit e dy prej këtyre produkteve/shërbimeve do të marrin pjesë dhe në trajnimin ndërkombëtar që do të organizohet nga Dhoma e Tregtisë së Seviile, Spanjë.

Kriteret përzgjedhëse janë:

- Inovacioni në prodhim apo tregtim të një produkti agroushqimor.
- Qëndrueshmëria e biznesit.

2. Kushtet për pjesëmarrjen

Aplikimet duhet të synojnë:

- Përmirësimin e produktit / shërbimit;
- Ritjen e fitimit për individët apo sipërmarrjet;
- Përmirësimin e veprimtarisë.

Përveç kësaj, të interesuarit duhet të jenë të regjistruar sipas legjislacionit tatimor shqiptar në çfarëdo forme tregtare (person fizik, biznes i vogël, biznes i madh etj.). Lejohet aplikimi në bashkëpunim mes dy të interesuarve.

3. Informacion për aplikimin

Formulari i aplikimit gjendet bashkangjitur kësaj thirrjeje dhe mund të shkarkohet në faqen e internetit të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë, aam.org.al dhe në faqen zyrtare të projektit.

Aplikimi mund të dërgohet me e-mail në adresën **aam@albmail.com**.

Për më shumë informacion, palët e interesuara ose mund të vizitojnë faqen e internetit të projektit: <https://mdnet.interreg-med.eu/> ose të kontaktojnë në adresën e mësipërme të emailit.

Afati i aplikimit është **25 tetor 2020** dhe aplikimet e përzgjedhura do të njoftohen më 28 tetor 2020.

Agron Haxhimali
Drejtor Ekzekutiv